



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
KRYESIA

204  
Nr.....Prot.

Tiranë, më 18.03.2021

Vendim

nr. 20 datë 16.03.2021

***Për shtyrjen e afatit të regjistrimit të kandidatëve që konkurrojnë për pranimin si anëtarë të Asamblesë sipas fushave të lira shpallur me vendimin nr. 12, datë 02.02.2021 të Kryesisë***

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 16 mars 2021, duke marrë parasysh kufizimet në komunikim ardhur prej pandemisë së shkaktuar nga Covid-19,

Vendosi:

1. Të shtyjë deri më 31 mars 2021 afatin e regjistrimit të kandidatëve që dëshirojnë të konkurrojnë për titullin *akademik i asociuar* sipas fushave të miratuara me vendim të Asamblesë në mbledhjen e datës 29 janar 2021 dhe të shpallura nga Kryesia me vendimin e saj nr. 12 datë 02.02.2021.
2. *Thirrja për pjesëmarrje*, publikuar më 02.02.2021, me ndryshimin në kalendarin sipas pikës 1 më sipër, të rishpallet në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave dhe të botohet në dy të përditshme gjatë tri ditëve.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: sekretari shkencor, kryetarët e seksioneve dhe specialisti i marrëdhënieve me publikun.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

KONC.SH.SINANI

